



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1101

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Isa Hasani - Anetar, duke vendosur sipas ankesës së OE FIDANI L SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik” me numër të prokurimit 632-25-2687-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 26/12/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e FIDANI L SH.P.K., me nr. 2025/1101 , e datës 07/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik”, me numër të prokurimit 632-25-2687-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik”, me numër të prokurimit 632-25-2687-5-1-1.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 6 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.04.2025 KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës në

Liqenin Erenik” me numër të prokurimit 632-25-2687-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **4,099,999.14€**

Me 17.10.2025 KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë: “World Medium SHPK& LimitProject SHPK &Adea Construction SHPK”.

Me 22.10.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 31.10.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 07.11.2025, OE FIDANI L SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1101, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues FIDANI L SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, pika 4, Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse (i) një devijim apo mos-përputhshmëri e tillë, apo gabim apo lëshim nuk ka ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pika 1.2: tenderin ekonomikisht më të favorshëm bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas paragrafit 3 të nenit 52 të këtij ligji.

Neni 64 Dëshmitë e kërkesave: Një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas neneve 68-

71 të këtij ligji.

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, pika 4.8: aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç kur një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë; pika 5: periudhat kohore të përcaktuara në këtë nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprin datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, pika 1: Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen.

Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë.

Dhe RREGULLORE NR. 002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, pika 26.6: certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së.

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 40.13: Komisioni vlerësues do të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Pika 40.14: Nëse AK ka përcaktuar kriteret për dhënien e kontratës "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm", dhënia e tillë do të jetë në bazë të kriterëve dhe peshës së kriterëve që janë specifikuar në dosjen e tenderit / njoftimin për kontratë.

Po ashtu janë shkelur Kriteret në FTD – Kërkesat e përshtatshmërisë: Kapaciteti teknik dhe profesional – Dëshmia e kërkuar dokumentare.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet: Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Për grupin e OE të shpallur fitues N.N.SH. WORLD MEDIUM; LIMITPROJECT SH.P.K.; ADEA CONSTRUCTION SH.P.K., në bazë të deklaratës së themelimit të grupit, lider N.N.SH. WORLD MEDIUM me 60%.

1. Pretendimi Nr. 1 – Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 8 - 1 (një) Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit - Drejtimi Hidroteknikë, i licencuar me licencë B nga Ministria e Mjedisit, i certifikuar për Menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet, minimum 4 vite përvojë pune pas diplomimit dhe certifikimit – i cili duhet të jetë i trajnuar sipas modulit 3 për Vlerësim preliminar të rrezikut nga përmbytjet.

Dëshmia 8 - Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë punë ose marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es. Certifikata të jetë valide.

Konstatimi dhe gjetjet për pretendimin Nr. 1:

Grupi i OE të shpallur fitues ka paraqitur në listë Z. Alban Xhema me përgatitje profesionale Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit - Drejtimi Hidroteknikë, me parakontratë bashkëpunimi nga anëtari i konsorciumit Adea Construction Sh.p.k. Për inxhinierin e lartcekur OE ka paraqitur:

Certifikatë Trajnimi për Menaxhim të Resurseve Ujore të lëshuar nga AQS Cert me nr. AQS/T/S31122020, sipas tyre e lëshuar me datë 18.04.2020 dhe certifikatën kinse të rivazhduar me datë 21.04.2023 me nr. AQS/T/S119192023. Në lidhje me këto dy certifikata kemi bërë verifikimin e tyre në platformën online të vetë AQS Cert, e cila është e qasshme në linkun: <https://www.aqscert.org/#regjistri-online>

. Në lidhje me këtë verifikim i bashkëngjesim kësaj kërkesë/ankese edhe provat gjegjëse nga të cilat rezulton se inxhinieri i paraqitur nga OE figuron si person vetëm i trajnuar e jo edhe i certifikuar. Madje edhe vetë certifikata e dorëzuar në lidhje me këtë inxhinier ka titullin “Certifikatë Trajnimi” e jo “Certifikatë Aftësimi Profesional” apo “Testimi”.

Certifikatë Trajnimi sipas Modulit 3 (Vlerësimi Preliminar i Rrezikut nga Përmbytjet) e ka paraqitur te AK në sqarime shtesë të datës 22.09.2025, gjegjësisht certifikatën me nr. AQS/T/S140002025, e cila datën e lëshimit e ka 10.05.2025.

Fillimisht është e qartë se kjo certifikatë dhe ky trajnim është i kryer pas publikimit të njoftimit të tenderit, pra nuk e plotëson kërkesën për 4 vite përvojë pune pas diplomimit dhe certifikimit sipas kërkesës së FTD-së. Pra, është tërësisht e qartë dhe pa asnjë dyshim se jo vetëm që përvoja e kërkuar nuk është e plotësuar konform FTD-së, por edhe vetë kjo certifikatë është e lëshuar për herë të parë pas shpalljes së tenderit. Kjo e bën të qartë se konsorciumi i shpallur fitues nuk i ka plotësuar as kriteret fillestare në bazë të FTD-së për sa ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional – lista e stafit profesional – Kërkesa nr. 8, gjegjësisht përvoja e punës pas diplomimit dhe certifikimit në këtë fushë.

Me rëndësi: OSHP gjatë trajtimit të kësaj ankese kërkojmë ta ketë parasysh që në asnjë pjesë të vendimit të atakuar me këtë ankesë, AK nuk ka përmendur shkeljet e pretenduara në lidhje me Modulin 3. Kjo pasi sikur t’i përmendte do të duhej t’i arsyetonte. Kjo nuk ka ndodhur pasi nuk ka pasur sesi t’i arsyetonte, e si rrjedhojë këtë pretendim për përvojën sipas Modulit 3 e ka lënë të patrajtuar fare.

Argumente shtesë: Sa i përket Certifikatës për Menaxhim të Resurseve Ujore sasi, cilësi dhe shëndet me nr. AQS/T/S31122020 datë 15.04.2020, konsiderojmë që kjo nuk është në rregull dhe është e manipuluar dhe e falsifikuar si certifikatë për të mashtruar dhe lajthitur AK-në. Në këtë certifikatë përshkruhet çuditërisht edhe numri Nr. N-0471 datë 14.11.2024, e që ky numër është saktësisht numri i licencës B të lëshuar nga MMPHI, dhe licencat B për herë të parë janë lëshuar në vitin 2024 pas vendimit me nr. 6259/24 të datës 01.10.2024 nga Komisioni Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit. Pra, si mund të figurojë përshkrimi i numrit të licencës B me nr. N-0471 në certifikatën e datës 15.04.2020, pasi në vitin 2020 nuk kanë ekzistuar fare licencat B? E në anën tjetër, nuk figuron fare niveli Bachelor apo Master. Në këtë certifikatë tek të dhënat për Alban Xhema, tek pjesa e arsimit shkruan: “Inxhinier i Ndërtimtarisë – Hidroteknikë” (pa specifikuar nivelin e studimeve Bachelor).

I njëjti përshkrim dhe argumentim vlen edhe për certifikatën me nr. AQS/T/S119192023 të rivazhduar më 21.04.2023, ku citohet tek pjesa e arsimit: “Inxhinier i Ndërtimtarisë – Hidroteknikë Nr. N-0471 Datë 14.11.2024”, ku ky numër është saktësisht numri i licencës B të Z. Alban Xhema të lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Edhe në vitin 2023 nuk kanë ekzistuar fare licencat B.

Nga ky argumentim është e qartë se këto dokumente të dorëzuara si “certifikata” janë tërësisht të falsifikuara dhe të përshtatura kundërligjshëm për të lajthitur dhe ndikuar me mashtrim tek AK për shpalljen e vendimit. Me rëndësi: në këto dy certifikata theksohet se janë rilesuar me datë 10.05.2025 me arsyetimin “Humbur origjinali”. Nëse ka humbur origjinali dhe rilesohet dokumenti i njëjtë edhe një herë (duplikat), informacionet bazë dhe përmbajtja e secilit dokument nuk guxon të ndryshohet por duhet të mbetet e njëjtë. Atëherë decidivisht i bie se pas rilesimit në këto certifikata është ndërhyrë në përmbajtje nga inxhinieri në fjalë, OE fitues ose nga AQCERT për arsye të përshtatjes me kriterin e përcaktuar në FTD.

Kjo për shkak se licenca B nuk ka ekzistuar as në vitin 2020 e as në vitin 2023 kur pretendohet të jenë lëshuar certifikatat e dorëzuara nga OE. Nuk mund të arsyetohet në asnjë mënyrë përshkrimi i një licence të mëvonshme në një dokument të nxjerrë si duplikat i një të mëhershmi, përveç nëse ka për qëllim lajthitjen e ndonjë organi publik. Kjo jo vetëm që është shkelje administrative në një procedurë tenderuese, por edhe vepër penale e falsifikimit të dokumenteve dhe legalizim i përmbajtjes së rreme. I njëjti inkriminim parashihet si me Kodin Penal të Republikës së Kosovës ashtu edhe me atë të Republikës së Shqipërisë. Dhënia e hapësirës për legalizim të këtyre dokumenteve të konsorciumit të shpallur fitues kundërligjshëm jo vetëm që do të duhej të ishte arsye për shpalljen e OE si të papërgjegjshëm, por do të duhej dërguar dokumentet gjegjëse në Prokurori, e kështu të mos na lihet neve që pashmangshmërisht të dërgojmë këtë çështje në Prokurori për hetim dhe për trajtim të shkeljeve që kanë rezultuar në legalizim të këtyre dokumenteve të falsifikuara qartazi me përmbajtje të kundërligjshme.

Këto certifikata edhe ashtu nuk janë të lëshuara nga ndonjë institucion publik, universitet apo ndonjë organ shtetëror i cili ka kredibilitet për të certifikuar në aspektin e aftësive dhe testeve për personel dhe staf në lidhje me menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet dhe Modulën 3, por janë certifikata trajnimi nga një kompani private e quajtur AQCERT nga Shqipëria, pra certifikatë e fituar kinse përmes trajnimit 3-ditor në online platformë, e cila i ndryshon, përshtat dhe plotëson këto certifikata sipas kërkesave dhe nevojave të çastit për klientët e vet përmes “rilëshimeve”.

Pra, përveç që AK do të duhej këto certifikata t’i konsideronte joadekuate për plotësimin e kriteve sipas FTD-së, do të duhej menjëherë që për të njëjtat të kërkojë sqarime se si kanë qenë certifikatat origjinale të cilat do të duhej t’i kishte në arkivën e vet, e po ashtu të lëshojë një kopje të origjinalit bashkë me certifikatën e rilëshuar së fundmi. Kështu edhe do të argumentohej qartazi se dosja e OE përgjegjës përmban dokumente të dyshuara si të falsifikuara.

Është me rëndësi për t’u përmendur se ky i ashtuquajtur AQS Cert në të njëjtën kohë operatorëve të ndryshëm ekonomik që kanë aplikuar në këtë tender ka lëshuar e rilëshuar certifikata me arsyetimin “Humbur origjinali”. Edhe pas kërkesës për rishqyrtim AK nuk e ka marrë parasysh dhe nuk ka ofruar ndonjë arsyetim apo sqarim që i ka kërkuar OE në fjalë, por vetëm refuzim të pikës si e pabazuar.

Pretendimi Nr. 2 – Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ISO:

ISO 9001:2015 – Certifikatë për Sistemet e Menaxhimit të Kualitetit

ISO 14001:2015 - Certifikatë për Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit

ISO 39001:2012 - Certifikatë për Menaxhimin e Sigurisë në Trafikun Rrugor

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ISO valide (kopje).

Konstatimi për pretendimin Nr. 2:

Në këtë grup operatorësh vetëm njëri nga anëtarët e konsorciumit ka paraqitur ISO certifikimet, Limit Project Sh.p.k, ndërsa lideri i grupit N.N.SH World Medium – i cili në bazë të deklaratës së themelimit të grupit është përcaktuar me 60% si lider i grupit – nuk ka ofruar asnjë nga këto ISO, e po ashtu edhe anëtari i tretë Adea Construction Sh.p.k nuk ka paraqitur ndonjë nga ISO-t e kërkuara. Si mund të udhëheqë grupin dhe punimet në terren një kompani lidere me 60% ku nuk ofron asnjë nga ISO-të e përcaktuara në FTD, ISO të cilat janë mbi cilësinë e punimeve në terren: ISO 9001:2015 - Certifikatë për Sistemet e Menaxhimit të Kualitetit, ISO 14001:2015 - Certifikatë për Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit, ISO 39001:2012 - Certifikatë për Menaxhimin e Sigurisë në Trafikun Rrugor.

Duke u bazuar në Nenin 70 të LPP-së dhe në Rregullore Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik:

Neni 26 – Grupi i Operatorëve Ekonomik, pika 26.6: Certifikatat për sigurimin e cilësisë përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare.

Vetëm në rastet e kontratave për furnizime paragrafi 26.8 thotë: Në rast të furnizimeve, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5 i LPP-së), atëherë një dëshmi i tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryejë furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbushur nga grupi si tërësi, por jo në rastet e kontratave të punëve dhe shërbimeve, e hiq më pak kur lideri i grupit nuk ofron certifikata ISO të tilla.

Pretendimi Nr. 3 – Paisjet dhe mekanizimi:

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.

Paisja Nr. 5 sipas listës Aneksi 7: Auto pompa për betonim me krahë me gjatësi minimum 37 m (autopompa duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit me afat valid të regjistrimit).

Konstatimi për pretendimin Nr. 3:

Grupi i OE ka paraqitur 3 autopompa me libreza: 01-869-PL në pronësi të All Stone, 05-490-FR në pronësi të STN Beton, 05-802-ER në pronësi të STN Beton me marrëveshje qiradhënie, por nuk ka paraqitur dëshmi dhe detaje për këto pompa sipas kriterit në FTD me krahë me gjatësi 37 m dhe AK nuk u ka kërkuar sqarime shtesë.

Pretendimi 4.

Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 2 – Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Siguri dhe Shëndet në Punë, se ka kryer vlerësimin e riskut konform Ligjit 04/L-161.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2 – Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja e licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë. GOE nuk kanë arritur ta dëshmojnë te gjitha anëtarët e grupit Raportin e vlerësimit.

Pretendimi Nr. 5.

Me datë 25.09.2025 AK dërgon Letër standarde Grupit të rekomanduar si fitues. Letër standarde e kërkesës për sqarim tenderi, saktësisht 1. Vërtetimin Tatimor, Vërtetimet nga gjykata 2.1, 2.2 dhe sigurimin origjinal.

Konstatimi për pretendimin Nr. 5.

Sipas Interpretimit të KRPP-së, datë 22.11.2022, ku thuhet: Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën-paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim:

Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP-së përcakton:

4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;”

Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton se çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të e interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit.

OE-të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së

duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.

Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm” ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprin datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme, p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jetë i pranueshëm.

Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jenë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Duke u nisur nga ky interpretim, të dy kompanitë e grupit të shpallur fitues e kanë ofruar Vërtetimin tatimor me obligime me këste në ATK, ku marrëveshjet për obligim të kësteve janë të nënshkruara pas datës së publikimit të tenderit, e ku sipas interpretimit ligjor OE ose duhet t’i kishte të gjitha obligimet tatimore të shlyera ose të kishte marrëveshjen për shlyerjen e borxheve me këste të nënshkruar para njoftimit të kontratës.

Me rëndësi:

N.N.SH. "WORLD MEDIUM" Burim Zabelaj B.I. e ka dorëzuar Vërtetimin tatimor të datës 08.09.2025 dhe në përshkrim thuhet: Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura. Ky OE ka ofruar marrëveshjen për shlyerje të obligimeve, por marrëveshja mban datën 11.06.2025, dmth. 2 muaj pas datës së publikimit të njoftimit të kontratës B05.

E po ashtu edhe anëtari tjetër i konsorciumit ADEA CONSTRUCTION SH.P.K ka të dorëzuar Vërtetimin tatimor të datës 22.08.2025 dhe në përshkrim thuhet: Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura. Ky OE ka ofruar marrëveshjen për shlyerje të obligimeve, por marrëveshja mban datën 22.08.2025, dmth. 5 muaj e disa ditë pas datës së publikimit të njoftimit të kontratës B05.

Për arsye se dosja ka qenë shumë voluminoze dhe e madhe, afati i dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim ka qenë i shkurtër pasi që AK vendimin e ka ngarkuar me datë 17.10.2025, ditë e premte në ora 14:48. Ne e kemi bërë menjëherë kërkesën për qasje në dokumentacion zyrtar, por vetëm ditën e hënë me datë 20.10.2025 na është mundësuar qasja. Prandaj këto detaje i kemi vërejtur vetëm pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe kërkojmë nga ana juaj që të trajtohen si pikë shumë me rëndësi.

Pra, për të gjitha pretendimet dhe konstatimet e lartcekura ofrojmë dëshmi dhe fakte të cilat i kemi marrë nga dokumentacioni në AK përmes qasjes zyrtare, andaj edhe i kemi bashkangjitur si pjesë e ankesës tonë.

Grup i Operatorëve Ekonomik:

Mendi-P SH.P.K.; D & T Group SH.P.K – me të drejtë i papërgjegjshëm edhe sipas vlerësimit të AK.

Grup i Operatorëve Ekonomik: BERISHA COM SH.P.K.; ILEAA-GR SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI-BAZE SH.P.K.

Lider i grupit: ILEAA-GR SH.P.K., 60% sipas deklaratës së konsorciumit.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Pretendimi 1.

Kërkesa 8 – 1 (një) Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit – Drejtimi Hidroteknikë, i licencuar me licencë B nga Ministria e Mjedisit, i certifikuar për Menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet, minimum 4 vite përvojë pune pas diplomimit dhe certifikimit – i cili duhet të jetë i trajnuar sipas modulit 3 për vlerësim preliminar të rrezikut nga përmbytjet.

Konstatimi për pretendimin Nr. 1

Grupi i OE ka paraqitur me parakontratë nga anëtari i konsorciumit BERISHA COM SH.P.K, si Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit – Drejtimi Hidroteknikë, Z. Lumi Popaj, i cili sipas kërkesës në FTD i mungon certifikimi adekuat për Menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet, minimum 4 vite përvojë pune pas diplomimit dhe certifikimit siç është kërkuar në FTD, pasi ka prezentuar një certifikatë me nr. AQS/T/S31132020 të datës 18.04.2020 dhe nr. AQS/T/S115812023 e ridhënë më 21.04.2023, ku thuhet “kurs trajnimi online” të AQSQCERT ACCADEMY, një agjenci në Shqipëri, e jo nga ndonjë universitet apo institut kredibil për natyrën e certifikimit.

Duke analizuar natyrën e projektit dhe natyrën e tij për menaxhimin e resurseve ujore, ky lloj certifikimi as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat e FTD-së dhe nuk e kalon as nivelin bazë për menaxhim të resurseve ujore. Edhe te këto dy certifikata për çudi rilesimi është në vitin 2025, pas publikimit të tenderit, si në rastin e mësipërm dhe me arsyetimin: Humbur origjinali.

Po ashtu, sipas kërkesës në FTD, i mungon përvoja 4-vjeçare, siç është kërkuar minimum 4 vite trajnimi sipas modulit 3 për vlerësim preliminar të rrezikut nga përmbytjet (trajnim–certifikim).

Ky trajnim–certifikim është shumë i rëndësishëm pasi edhe projektuesi i këtij projekti e ka paraparë në Përshkrim Teknik: 5. Moduli hidraulik i vërshimeve për liqenin dhe pendën.

Z. Lumi Popaj posedon një certifikatë trajnimi ku shkruan “trajnim i zhvilluar online”, data e trajnimit është 07.05.2025–10.05.2025 (3 ditë), që do të thotë se personi në fjalë posedon një certifikatë-trajnim jo adekuat për natyrën e punimeve dhe 1 muaj përvojë të dokumentuar me certifikatën e tij për modulin 3 për vlerësim preliminar të rrezikut nga përmbytjet. Certifikimi/Trajnimi për modulin 3 është mbajtur pas datës së publikimit të tenderit.

Pra, është tërësisht e qartë dhe pa asnjë dyshim se jo vetëm që përvoja e kërkuar nuk është e plotësuar konform FTD, por edhe vetë kjo certifikatë është e lëshuar për herë të parë pas shpalljes së tenderit.

Pretendimi Nr. 2

Kërkesa 9 – 1 (një) Inxhinier i diplomuar apo Master i Shkencave Teknike – drejtimi Mbrojtje e Ambientit/Mjedisit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i licencuar me VNM – Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.

Dëshmia 9 – Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë pune ose marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es. Licenca të jetë valide.

Konstatimi për pretendimin Nr. 2

Grupi i OE ka paraqitur me parakontratë nga anëtari i konsorciumit BERISHA COM SH.P.K, Z. Pajtim Bytyçi, i cili në bazë të diplomave të prezantuara ka përfunduar nivelin Bachelor në Biologji në vitin 2012 në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore në Prishtinë, ndërsa në bazë të diplomës së prezantuar për nivelin Master (2014) ka titullin Master i Shkencave të Biologjisë, e po ashtu ka prezantuar edhe diplomë të doktoraturës (27.11.2023) me titullin Doktor i Shkencave të Biologjisë.

Pra, në bazë të kërkesës së FTD-së është kërkuar Inxhinier me sistemin e vjetër të shkollimit ose Master i Shkencave Teknike – drejtimi Mbrojtje e Ambientit/Mjedisit, e jo Biolog me kualifikim.

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas pajisjeve dhe mekanizmit të obligueshëm në tabelën e Aneksit 7 të DT.

Pretendimi Nr 3.: Pajisja Nr. 10 sipas listës Aneksi 7: Eskavator super strukturë rrotulluese me goma me peshë totale minimum 26 t.

Konstatimi për pretendimin Nr. 3: OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K ka prezantuar në listën e ankesit 7 të plotësuar Eskavator Liebherr Tipi L922 me nr. serik 48035406, por në dëshminë e ofruar për këtë eskavator mungojnë dëshmitë dhe specifikat e kërkuara në FTD, dudi doganor ose ndonjë faturë blerjeje. Është ofruar një dokument i datës 13.12.2008, i cili përshkruhet si “Evidencë e paraqitjes”, e cila në përmbajtjen e saj nuk e saktëson në asnjë mënyrë llojin e këtij eskavatori dhe karakteristikat e tij si mjet; në këtë dokument shkruan “bager i përdorur” dhe asgjë më shumë.

Në bazë të deklaratës importuese të vitit 2008 ky eskavator është importuar nga subjekti JOOSKRASNIQI LIMITED CONSTRUCTION SH.P.K me nr. biznesi 70524570, dhe nuk është ofruar ndonjë dëshmi mbi pronësinë e tij nga OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K si ofertues në tender, e as ndonjë marrëveshje mbi qiramarrjen, pasi këto dy subjekte afariste janë të ndara dhe kompani secila më vete. Në ARBK ekzistojnë si subjekte të ndara edhe në ATK. Pra, të dy subjektet afariste janë të ndara dhe aktive.

Pretendimi Nr 4: Pajisja Nr. 16 sipas listës Aneksi 7 – Bager–grejder me peshë totale minimum 12 ton.

Konstatimi për pretendimin Nr. 4: OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K ka paraqitur në list 3 të tillë, por vetëm njëri nga ta është bager-grejder. Pajisja e paraqitur si grejder, eskavator i prodhuesit Liebherr, tipi Kettenbager R 916 Litronic, peshë 26 ton, nuk është grejder por eskavator me rrotullim superstrukture 360°, gjë që shihet saktë edhe në bazë të faturës së blerjes të paraqitur mbi pronësinë nga JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K dhe dudit doganor të importimit.

Po ashtu, pajisja tjetër e paraqitur si grejder në pronësi të JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K, në bazë të dudit doganor të importimit, shkruan saktë: “Makineritë me rrotullim të superstrukturës 360°, eskavatorët track – Marka: WACKER-NEUSON, Tipi: EW100, Kë: 55, Viti i prodhimit: 2019, Nr. i shasisë: WNCE060CPAL01558, peshë 12,778 kg”. Pra, sasia e kërkuar nga AK është 2 copë, ndërsa OE ka ofruar vetëm një makineri e cila e plotëson kërkesën e FTD-së Aneksi 7 si grejder, ndërsa dy të tjerat nuk janë grejder por eskavatorë të natyrës krejt tjetër.

Pretendimi Nr 5: Pajisja Nr. 21 sipas listës Aneksi 7 – Traktor me krah minimumi 7,50 m për prerjen e drunjëve, barit dhe pastrim të terrenit. Fuqia min. (KË 115) – (traktori duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit).

Konstatimi për pretendimin Nr. 5: OE BERISHA COM SH.P.K ka paraqitur në list një mjet të emërtuar si traktor, i cili është marrë me marrëveshje qiraje nga personi fizik Z. Drilon Casanova, dhe në bazë të librezës së paraqitur ky mjet nuk i plotëson specifikat e kërkuara sipas FTD-së. Në librezë shkruan “traktor me kabinë” dhe asgjë më shumë.

OE BERISHA COM SH.P.K ka paraqitur në list edhe disa pajisje përcjellëse kositëse me marrëveshje qiraje nga Anuar Shpk, të cilat pajisje, në bazë të dudit doganor, nuk janë pajisje që mund të montohen në traktor, por pajisje që montohen në kamion. Sipas përshkrimit në dudit doganor: “Pajisje për prerje të vegjetacionit që montohen në kamion”. Pra, traktori nuk posedon pajisjet për prerje; si mund të vendosen pjesë përcjellëse për prerje të kamionit në traktor – dy gjëra të kundërta me njëra-tjetrën.

OE BERISHA COM SH.P.K në list ka paraqitur një kamion me krah me marrëveshje qiraje nga Anuar Shpk, dhe në bazë të librezës së paraqitur me nr. të tabelave 01-586-EM, decizivisht shkruan “kamion për pastrimin e rrugëve nga bora”; kjo pajisje e ofruar nuk e plotëson kërkesën sipas FTD-së.

Pretendimi Nr 6: OE BERISHA COM SH.P.K me datë 22.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim në AK.

Konstatimi për pretendimin Nr. 6: Në bazë të deklaratës Aneksi 8 për themelim të grupit, ILEAA-GR Shpk është lider me 60%, andaj në bazë të kësaj deklarate: “Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të të drejtës për ankesë, si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.”

Andaj, AK i ka shkelur këto dy nene të LPP-së duke ia trajtuar, rishqyrtuar dhe refuzuar me arsyetimet e tyre si AK sipas pretendimeve të kompanisë ankuese, pra kjo kërkesë për rishqyrtim nuk është dashur të rishqyrtohet pasi që nuk është konform neneve të LPP-së. AK e këshillon që në afat prej 10 ditësh të paraqesë ankesë pranë OSHP-së, por është dashur të hidhet poshtë si e palejuar pasi është parashtruar nga anëtari jo-lider i konsorciumit.

Për të gjitha pretendimet dhe konstatimet e lartëcekura ofrojmë dëshmi dhe fakte të cilat i kemi marrë nga dokumentacioni në AK përmes qasjes zyrtare, andaj edhe i kemi bashkangjitur si pjesë e ankesës tonë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.10.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet për Grupin e Operatorëve Ekonomik NNSH "WORLD MEDIUM"; "LIMITPROJECT" SH.P.K.; "ADEA CONSTRUCTION" SH.P.K.:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse 4 vite përvojë janë kërkuar pas diplomimit dhe certifikimit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, kualitetit, Sigurisë dhe Sasisë së tyre. Lidhur me certifikatën e Ing. Alban Xhema, nuk qëndron, sepse në bazë të nenit 61 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/1-092 dhe nenit 74 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara nga operatorët ekonomikë. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues me dt. 29.10.2025 i është drejtuar AQSCERT sh.p.k., e cila ka lëshuar certifikatën në fjalë, duke kërkuar nga e njëjta që të konfirmojë vërtetësinë e këtij dokumenti. Po të njëjtën ditë, dt. 29.10.2025, AQSCERT sh.p.k. i është drejtuar Autoritetit Kontraktues me shkresë, ku konfirmon vërtetësinë e këtyre certifikatave.

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron sepse kërkesa për ISO-të është kërkuar në FDT tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale". Bazuar në nenin 69 paragrafi 8 i LPP-së, mjafton që vetëm njëri nga anëtarët e grupit të prezantojë dokumentet e kërkuara: "Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera."

Pretendimi juaj lidhur me autopompat për betonim me krah minimum 37m nuk qëndron, sepse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar librezën e qarkullimit dhe me këtë ka plotësuar kërkesën e FDT-së.

Pretendimi juaj lidhur me kërkesën për Raportin e vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Siguri dhe Shëndet në Punë, nuk qëndron sepse e njëjta është kërkuar në FDT tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale". Bazuar në nenin 69 paragrafi 8 i LPP-së, mjafton që vetëm njëri nga anëtarët e grupit të prezantojë dokumentet e kërkuara: "Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera." Çka nënkupton se Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesën e FDT-së.

Pretendimet për Grupin e Operatorëve Ekonomik "BERISHA COM" SH.P.K.; "ILEAA-GR" SH.P.K.; "JOOS & KRASNIQI-BAZE" SH.P.K.:

Pretendimi juaj lidhur me certifikatën e Ing. Lumi Popaj nuk qëndron, sepse i njëjti ka prezantuar Certifikatën e trajnimit për "Vlerësimin preliminar të rrezikut nga përmblytjet" të lëshuar me dt. 18.04.2020 dhe Licencën "B", duke plotësuar kështu kërkesën në FDT.

Pretendimi juaj lidhur me Ing. Pajtim Bytyqi nuk qëndron, sepse i njëjti ka kryer Masterin e Shkencave Biologji, drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Ambientit në vitin 2014 dhe është i licencuar si person fizik për hartimin e raporteve VNM. Gjithashtu është Doktor i shkencave në mjedisin jetësor.

Pretendimi juaj lidhur me kërkesën nr. 10 të listës së makinerive – Eskavator super strukturë rrotulluese me goma me peshë totale minimum 26t, qëndron, por kjo nuk ndryshon Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, sepse Grupin e operatorëve ekonomik në fjalë Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar si të pasuksesshëm.

Pretendimi juaj lidhur me kërkesën nr. 16 të listës së makinerive – Bager-grejder me peshë totale minimum 12 ton, qëndron, por kjo nuk ndryshon Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, sepse Grupin e operatorëve ekonomik në fjalë Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar si të pasuksesshëm.

Pretendimi juaj lidhur me kërkesën nr. 21 të listës së makinerive – Traktor me krah minimum 7,50 m për prerjen e drunjëve, barit dhe pastrim të terrenit. Fuqia min. (KW 115) – (traktori duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), nuk qëndron, sepse në DUD-in doganor të kamionit të prezantuar nga Grupi i operatorëve ekonomik në fjalë ceket se i njëjti shërben për pastrimin e rrugëve nga bora dhe posedon platformën për prerjen e drunjëve, barit, etj., duke plotësuar kështu kërkesën në FDT.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1101, ndërsa me datë 19.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1101, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht i bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Fidani L SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1101 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik” me nr. të prokurimit: "632-25-2687-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi me i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, për faktin se OE ankues është shpallur i pasuksesshëm me çmimin më të lartë se sa OE i rekomanduar.

Tutje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues, i njëjti konform nenit 109 të Ligjit për Prokurim Publik parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat, dhe se gjatë vlerësimit të ofertave shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht dispozitat ligjore: 59.4, 60, 64, 65, 69, 70, gjithashtu dispozitat ligjore të Rregullores për Prokurim Publik nr.002/2024 plotësim ndryshim, nenet:26, 26.4, 40, 40.13, 40.14.

Bazuar në nenit 64.2 të Rregullores për Prokurim Publik i konsoliduar nr. 002/2024 dt:11/11/2024, pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim, citat:”64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar “Ankesat”. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues”

Kurse OE ankues në ankesë ka shtuar pretendime ankimore shtesë kundër OE të rekomanduar.

Vërejtje: Pretendimet e plota të OE ankues janë të parashtruara në pjesën lartë të raportit, përkatësisht tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore!

Pretendimi i parë i OE ankues:

OE ankues në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesë pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket inxhinierit të hidroteknikës, përkatësisht nuk ka ofruara Certifikatat origjinale për menaxhim të resurseve ujore si dhe certifikimi për trajnimin në modulin 3 për vlerësim preliminar i rrezikut nga përmbytjet, duke pretenduar se certifikatat janë për trajnime dhe jo certifikatë për aftësim, të cilat sipas OE ankues dyshohet se janë të manipuluar për shkak se në të njëjtat është e shkruar numri i licencës B e cila nuk ka ekzistuar në kohën e certifikimit.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të publikuara në E-prokurim sqaron se, AK në DT ka kërkuar si kërkesë nr.8 mbi aftësitë teknike dhe profesionale:

Kërkesa 8 - 1 (një) Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit – Drejtimi Hidroteknikë, i licencuar me licencë B nga Ministria e Mjedisit, i certifikuar për Menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet, minimum 4 vite përvojë pune pas diplomimit dhe certifikimit – i cili duhet të jetë i trajnuar sipas modulit 3 për vlerësim preliminar i rrezikut nga përmbytjet.

Dëshmia 8 - Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë punë ose marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt, ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es. Certifikata të jetë valide.

Tutje, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet inxhinieri Bachelor i diplomuar nga viti 2015, me referenca, CV, dhe Licencë valide B nga Ministria e Mjedisit, posedon certifikatën e cila është e ri lëshuar me arsyetimin “humbja e origjinalit” valide. Rrjedhimisht, lidhur me paragjykimet/dyshimet e OE ankues për certifikimet të ri lëshuara si humbje nga origjinali, bazuar në përgjigjen e Autoritetit Kontraktues, ky i fundit konform nenit 52.7 të LPP-së, ka të drejtë të bëjë një hulumtim të çfarëdo dokumenti në rast të se dyshon, dhe në rastin konkret i njëjti konstaton se ka verifikuar dhe konfirmuar certifikatat, andaj sipas kërkesës së AK-së certifikatat janë valide dhe të verifikuara nga AK, ndërsa specifikimi i numrit të licencës B në certifikatë, nuk mund të konsiderohet si e dyshimtë për faktin se meqë dokumenti është ri lëshim, institucioni ka mund që ta pasuroj dokumentin edhe me numrin e licencës, mirëpo nuk mund të merret si indikator për mashtrim!

Citat neni 52 par.7 LPP” 7. Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.”

Vlen të theksohet se certifikatat ose dokumentet mund të vlerësohen si të mirëqenë deri një ditë para hapjes së ofertave, pra edhe nëse janë pas publikimit të njoftimit për kontratë, por kanë ekzistuar para hapjes së ofertave, pra mbi bazën e nenit 72 par. 2 dhe 3 të LPP-së, AK mund të kërkoj sqarime, citat:” 2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”

Gjithashtu Licenca B dhe Licencat e tjera në përgjithësi të lëshuara nga MMPHI si kusht për kualifikim kanë përvojën e cila kërkohej varësisht nga niveli i kualifikimit, e cila përvojë profesionale kërkohej të dëshmohet nga aplikuesit gjatë aplikimit, andaj përvoja nga viti 2015 prej diplomimit të inxhinierit konsiderohet e mirëqenë. Si e tillë pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Pretendimi i dytë i OE ankues:

OE ankues pretendon se nga OE i rekomanduar nuk janë ofruar ISO standardet si certifikata nga të gjithë anëtarët, gjithashtu nuk është ofruar nga lideri nga i cili kërkohej 60%, i njëjti nuk ka ofruar ISO standardet. Sepse sipas nenit 70 të LPP-së këto certifikata dëshmojnë cilësinë e punimeve në teren, ndërsa nuk janë sjellë nga lideri.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar gjenden ISO standardet nga anëtari i konzorciumit, dhe bazuar në nenin 26.6 të RrPP nr. 002/2024 dt:11/11/2024, nuk përcaktohet se duhet të përmbushet nga secili anëtar i grupit apo nga lideri, mirëpo ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo kërkesë që të përmbushet nga

secili anëtar ka qenë në Rregulloren e Prokurimit Publik nr. 001/2022, neni 26.6, mirëpo tani pjesa e fundit është larguar. Andaj Grupi i OE të rekomanduar kanë përmbushur kërkesën. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Citat neni 26.6 i Rregullores për Prokurim Publik nr.002/2024 dt.11/11/2024:

26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përputhshmërinë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare.

Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankues se lideri është kërkuar që të përmbushë 60%, AK ka konform nenit 68 dhe 69 në DT kërkesat 8.1&8.2 si dhe 9.1&9.2 ka kërkuar që lideri të përmbush 60 % të kërkesave, pra qarkullimin dhe listën e kontratave.

Citat neni 26.10 i Rregullores për Prokurim Publik nr. 002/2024 dt.11/11/2024:

26.10” Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE.”

Pretendimi i tretë i OE ankues kundër OE të rekomanduar:

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk posedon pajisjen e kërkuar në Aneks 7 pajisja numër 5, dy auto pompa për betonim me krahë, sepse i njëjti nuk ka ofruar dëshmi lidhur me gjatësinë e krahut 37 m.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër OE të rekomanduar:

Ekspertja Shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se, AK në aneks 7 si kërkesë numër 5 ka kërkuar “Auto pompa për betonim, me krahë me gjatësi minimum 37m (auto pompa duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit me afat valid të regjistrimit)”, gjithashtu në ofertën e OE të rekomanduar gjenden 3 Auto pompa për betonim, të cilat kanë të dëshmuar librezat e regjistrimit valid, ndërsa sa i përket gjatësisë së krahut, AK gjithashtu ka marrë të mirëqenë pajisjen për faktin se në librezë specifikohet tipi i pajisjes e cila specifikon krahun, andaj marrë parasysh natyrën e projektit, këto pajisje janë marrë të mirëqenë nga AK konform nenit 59 par 4 të LPP-së. Pretendimi nuk gjendet i qëndrueshëm.

59 par.4 LPP citat:

4. “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në

dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”

Pretendimi i OE ankues kundër OE të rekomanduar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale. Kërkesa 2- Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Siguri dhe shëndet në punë. Dëshmi kërkohet kopja e raportit të vlerësimit, kurse OE i rekomanduar nuk kanë arritur ta dëshmojnë nga të gjithë anëtarët e grupit.

Përgjigje në pretendimin e OE ankues kundër OE të rekomanduar:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se, AK në DT si kërkesë 9.1&9.2 kapaciteti teknik ose profesional si kërkesë numër 2 ka kërkuar:

Kërkesa 2 - Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Siguri dhe shëndet në punë, se ka kryer vlerësimin e riskut konform ligjit 04/L-161.

Dëshmia 2 - Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja e licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë.

Dhe në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë gjendet raporti i vlerësimit si grup në tërësi konform nenit 26.5 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 002/2024, për faktin se neni 68 dhe 69 aplikohet si grup në tërësi. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

26.5 “Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), neni 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe neni 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”

Tutje, OE ankues përkundër nenit 109 të LPP-së e cila specifikon se ankesa duhet të përmbajë pretendimet ankimore si në kërkesën për rishqyrtim, mirëpo OE ankues si pretendim shtesë ka parashtruar edhe Vërtetimet tatimore të ATK, i cili pretendon se marrëveshjet për shlyerje të borxheve dy operatorët ekonomik të rekomanduar e kanë pas datës së publikimit të tenderit, ndërsa pretendon se sipas interpretimit ligjor të KRPP-së OE duhet ti kishte të gjitha obligimet të shlyera ose të kishte marrëveshje për shlyerjen e borxheve me këste të nënshkruar para njoftimit për kontratë.

Ekspertja shqyrtuese përkundër se ky pretendim ankimor i OE ankues nuk është i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim, megjithatë sqaron se, sipas interpretimit të KRPP-së, meqë OE ankues i referohet këtij interpretimi citat:

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht”

nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë "të pranueshëm" për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë "të pranueshëm" kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë "Deklaratën nën betim" me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "i pranueshëm" OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të paslyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Atëherë pra referuar në interpretimin e KRPP-së, Operatorët Ekonomik fillimisht gjatë publikimit të njoftimit për kontratë mund të mos kenë borxhe në ATK, mirëpo gjatë rrugës pra është fjala për një periudhë nga data e publikimit të njoftimit për kontratë 02/04/2025 dhe deri te hapja e ofertave me datë 17/10/2025, andaj marrëveshja për shlyerje të borxheve mund të lindin brenda kësaj periudhe e cila është e mbuluar me marrëveshje. Pra si e tillë mbetet gjithashtu edhe në diskrecion të AK që nëse është e nevojshme të kërkojë një regjistër të pagesave ose çfarëdo dokumenti që i përket kërkesës sipas nenit 65 të LPP-së. Andaj pretendimet e OE ankues kundër OE të rekomanduar nuk gjenden të bazuara për faktin se AK ka vlerësuar ofertat në harmoni me nenin 1,6,7, 59 par.4, 72, dhe nenit 60- kriteri i dhënies çmimi më i ulët i përgjegjshëm me një diferencë nga OE ankues rreth 300 000 euro më i lirë.

Tutje, OE ankues ka parashtruar pretendime ankimore edhe kundër operatorëve të tjerë në procedurë.

I njëjti për grupin e operatorëve ekonomik Mendi-P SHPK; D&T Group SHPK pretendon se me të drejtë është eliminuar dhe është i pa përgjegjshëm sipas vlerësimit të AK-së.

Ekspertja shqyrtuese lidhur me grupin e operatorëve ekonomik në fjalë sqaron se, AK të njëjtit gjatë vlerësimit ka eliminuar për disa arsye në mosplotësim të kërkesave të dosjes së tenderit, andaj meqë të njëjtit nuk janë ankuar atëherë si e tillë janë pajtuar me vlerësimin e Autoritetit Kontraktues. Pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.

Pretendimet ankimore të OE ankues kundër Grupit të Operatorëve Ekonomik Berisha COM SHPK; ILEAA -GR SHPK, JOOS & KRASNIQI-BAZË SHPK.

Pretendimi i parë:

OE ankues pretendon se ky grup i OE nuk plotëson kërkesën numër 8 të dosjes së tenderit sepse certifikatat janë ri lëshuar nga një kompani në Shqipëri dhe nuk është ndonjë universitet apo

institut kredibil për natyrën e certifikimit. Andaj nuk e plotëson kërkesën sepse kjo certifikatë po ashtu është lëshuar pas shpalljes së njoftimit për kontratë.

Përgjigje në pretendimin ankimor:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e GOE në fjalë gjendet bachelor i hidroteknikës i diplomuar në vitin 2018, i cili posedon Licencën B valide, certifikatat janë valide, referenca mbi përvojën e punës dhe si e tillë, AK konform nenit 52.7 të LPP-së, mund të verifikoj çdo informatë të dyshuar, ndërsa certifikatat, diplomat etj. mund të merren të mirëqenë edhe gjatë sqarimeve, dhe pranohen deri para datës së dorëzimit të tenderëve, si në sqarimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese në pretendimin ankimor kundër GOE të rekomanduar. Pretendimi nuk gjendet i qëndrueshëm.

Pretendimi i dytë:

OE ankues pretendon se GOE nuk ka plotësuar kërkesën numër 9 të DT-së, sepse ztr.P.B posedon kualifikimin doktor i shkencave të biologjisë në fakultetin e shkencave matematikore natyrore në Prishtinë, ndërsa kërkesa ka qenë Inxhinier me sistemin e vjetër të shkollimit ose master i shkencave teknike-drejtimi [Mbrotje të Ambientit-Mjedisit me 5 vite e jo Biolog me kualifikim.

Përgjigje në pretendimin ankimor:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë ankimor të OE ankues kundër GOE në fjalë sqaron se, inxhinieri është doktor shkence në fakultetin e biologjisë, mirëpo nuk mund të konsiderohen si drejtime të barasvlershme, për arsye se shkencat teknike dallojnë nga shkencat matematikore-natyrore, mirëpo po që se do të ishte ky pretendim crucial në rezultatin final të vlerësimit, atëherë AK do të kërkonte sqarim nga institucionet përkatëse për nostrifikim dhe barasvlerësim, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i tretë, katërt, pestë:

OE ankues pretendon se GOE lidhur me pajisjen nr. 10, 16, 21 sipas aneksit 7 të DT-së, sepse nuk e plotësojnë kërkesën sipas dosjes së tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se, në ofertë gjenden lista e pajisjeve të dëshmuara me dud doganor, fatura, marrëveshje, të cilat po që se do të ishin të rëndësishme për vendimmarrje dhe vlerësim final, të njëjtat konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkojnë që të sqarohen, mirëpo në rastin konkret ky grup i operatorëve ekonomik është shpallur i pasuksesshëm me çmimin më të lartë se sa OE i rekomanduar, atëherë si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i gjashtë:

OE Berisha COM SHPK me datë 11.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, mirëpo i njëjti nuk është lider i grupit, andaj nuk është dashur që të shqyrtohet nga AK sepse konform nenit 108A dhe 109 të LPP-së anëtarin nuk ka të drejtë të parashtroj ankesë.

Përgjigje në pretendimin ankimor:

Në ofertën e grupit të OE gjenden deklaratat, dhe deklarata mbi themelimin e grupit, me të cilin si lider është përcaktuar ILEAA-GR SHPK. Pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.

SI përfundim, OE ankues në ankesën e paraqitur pranë OSHP-së ka ngritur pretendime kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar, si dhe ndaj operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurë, të cilët kanë ofruar çmime më të ulëta se sa OE ankues. Nga shqyrtimi i pretendimeve të drejtuara kundër Grupit të Operatorëve Ekonomik të rekomanduar, rezulton se ato nuk janë të bazuara, pasi AK ka vlerësuar ofertat në përputhje me nenin 59, paragrafi 4, në harmoni me nenet 1, 6, 7, 62 dhe 72 të LPP-së. Për këtë arsye rekomandohet që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi. Ndërkaq, pretendimet e OE ankues kundër operatorëve të tjerë në procedurë rezultojnë pjesërisht të bazuara. Si rrjedhojë, ankesa në tërësi aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së mbetet në fuqi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, por që nuk qene të mjaftueshme për të ndryshuar epilogun përfundimtar të vendimit të AK.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues KOMUNA E GJAKOVËS, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik” me numër të prokurimit 632-25-2687-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - FIDANI L SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: